



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.4.2023

Nr: 241

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KËSHILLIT BASHKIAK, BASHKIA KAMËZ, TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR "ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 3.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën:

**KËRKUES:** Partia "Aleanca Demokristiane e Shqipërisë" me shkronja nistore "ADK"

**OBJEKTI:** Miratimi i listës shumëmeore të Këshillit Bashkiak, Bashkia Kamëz, të subjektit zgjedhor "Aleanca Demokristiane e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", dhe të shkronjës "a", të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Presidenti i Republikës me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Data:3.4.2023 Nr: 241  
Ora:16:00



"Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumëmeore të këshillit bashkiak, Bashkia Kamëz, të subjektit zgjedhor "Aleanca Demokristiane e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Me vendimin nr. 124, datë 8.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Partia “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbështetje të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, për bashkinë Kamëz të subjektit zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Kamëz të subjektit zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik.

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak rezulton se, të gjithë kandidatët e listave shumëmemërore nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit elektronik. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me anë të komunikimit elektronik në datën 29.3.2023 ka dërguar verifikimin e të dhënave për të gjithë kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për bashkinë Kamëz të subjektit zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, sipas së cilës rezulton se:

1. Kandidatët e propozuar nga subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, në listën shumëmemërore për këshillin bashkiak **Kamëz** (sipas lidhjes nr. 1), nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015 pasi rezultojnë të jenë të padënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak për Bashkinë Kamëz, të subjektit zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”. Referuar ligjit, nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose shtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të subjektit zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumëmemërore të subjektit zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe në nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

#### **V E N D O S:**

1. Miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, në bashkinë Kamëz, të subjektit zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data:3.4.2023 Nr: 241  
Ora:16:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumëmemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Kamëz, të subjektit zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

**Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë****Bashkia Kamëz****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Atësia</b>	<b>Mbiemri</b>	<b>Datëlindja</b>	<b>Gjinia</b>
1	Pashk	Gjon	Pepkolaj	20/04/1966	M
2	Mirela	Pashk	Pepkolaj	28/10/1998	F
3	Edmond	Pashk	Pepkolaj	30/08/2001	M
4	Kristiana	Nikoll	Vatnikaj	24/12/1996	F
5	Andrea	Pashk	Pepkolaj	29/12/2003	M
6	Mire	Pjetër	Vatnikaj	14/11/1963	F
7	Sokol	Lekë	Vatnikaj	16/01/1990	M
8	Brunilda	Zef	Hasani	30/10/2001	F
9	Fjordi	Ramadan	Cani	14/12/2004	M
10	Anisa	Pllum	Gjoka	26/09/1999	F
11	Eris	Tonin	Pepkolaj	03/08/2004	M
12	Dajana	Zeqir	Kaloshi	01/11/1994	F
13	Arjan	Halil	Murati	10/07/1988	M
14	Dorina	Ali	Lena	15/08/2002	F
15	Arsim	Lavdrim	Lita	03/10/2003	M
16	Jurgena	Lili	Uka	26/07/1998	F
17	Kledi	Agim	Përvataj	22/10/2001	M
18	Silvana	Simon	Pepkolaj	30/07/2000	F
19	Denis	Hekuran	Coka	30/06/2004	M
20	Dila	Zef	Lika	20/09/1954	F
21	Aleks	Gezim	Rrucaj	30/09/1998	M
22	Aferdita	Pjetër	Pepkolaj	07/09/1976	F
23	Ervis	Xhevit	Qema	07/03/1991	M
24	Luljeta	Lek	Hasani	23/07/1980	F
25	Xhevahir	Jusuf	Korbi	09/07/1961	M
26	Matilda	Simon	Pepkolaj	24/07/1996	F
27	Indrit	Kadri	Ajazi	08/12/1995	M
28	Anxhelina	Imer	Hidri	24/05/2001	F
29	Everest	Ali	Kananaj	07/11/1981	M
30	Gentjana	Agim	Pervataj	04/02/1999	F
31	Tonin	Ali	Gjonpalaj	05/09/1961	M
32	Drijola	Dritan	Karaj	04/11/1994	F
33	Gjergj	Zef	Bushgjokaj	29/04/1950	M
34	Rina	Sabri	Lala	16/12/2003	F
35	Arjan	Hamit	Loka	11/12/1973	M
36	Denisa	Zef	Hasani	15/08/2004	F



**Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë****Bashkia Kamëz****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Atësia</b>	<b>Mbiemri</b>	<b>Datëlindja</b>	<b>Gjinia</b>
37	Alban	Shqefen	Pepkolaj	20/11/1985	M
38	Teuta	Gjergj	Bushgjokaj	23/05/1984	F
39	Arbër	Shqefen	Pepkolaj	22/07/1990	M
40	Xhemile	Hasan	Bushgjokaj	20/09/1952	F
41	Olsion	Bujar	Stafasani	09/03/2002	M
42	Indrit	Petrit	Kashi	29/10/1987	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

42